



## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË ABONIMIT NË SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT ME PARAPAGIM DHE ME FATURIM MUJOR PËR PËRDORUES PRIVAT TË OFRUARA NGA IPKO TELECOMMUNICATIONS SH.P.K

### Neni 1 - Përbajtja e Kushteve të Përgjithshme të Abonimit

1.1 Kushtet e Përgjithshme të Abonimit në Shërbimet e Telekomunikimit me Parapagim si dhe me Faturim Mujor (këtu e tutje referuar si “**Kushtet e Përgjithshme të Abonimit**”), për Përdorues Privat (këtu e tutje referuar si “**Përdoruesi**”), të ofruara nga IPKO Telecommunications SH.P.K. (këtu e tutje referuar si “**IPKO**”), përbajnë të dhënat e përgjithshme, mbi kushtet e abonimit në shërbimet e ofruara nga IPKO për Përdorues, duke përfshirë këtu Përdoruesit që përzgjedhin të aktivizojnë shërbime me faturim mujor dhe/apo me parapagim.

1.2 Kushtet e Përgjithshme të Abonimit, janë të aplikueshme për të gjithë personat fizik, të cilët, kanë nënshkruar Kontratë Abonimi për njërin apo më shumë nga shërbimet që ofrohen nga IPKO dhe këto Kushte të Përgjithshme të Abonimit, së bashku me Kushtet e Veçanta të Abonimit si dhe shtojcat e tjera të Kontratës, konsiderohen pjesë integrale të së njëjtës.

1.3 Përveç këtyre Kushteve, mënyra dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve me faturim mujor të telekomunikimit për përdorues privat nga IPKO, do të udhëhiqen gjithashtu nga Ligji për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109, nga rregulloret e aplikueshme për ofrimin e shërbimit të telekomunikimeve elektronike, në Kosovë të miratuara nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm referuar si “**ARKEP**”); nga Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, e miratuar nga Komisioni i Pavarur për Media (në tekstin e mëtejshëm referuar si “**KPM**”); si dhe nga Kontrata e Abonimit, nga Kushtet e Veçanta për abonim në shërbimet me faturim mujor të telekomunikimit, nga oferta, shtojcat përkatëse, çmimet e publikuara të IPKO’s, si edhe dokumentet e tjera të nënshkruara nga Përdoruesi dhe IPKO, të cilat, në tërësi, përbëjnë Marrëveshjen.

### 2. Definicionet

“**Marrëveshja**” do të thotë e tërë marrëdhënia kontraktuale midis Përdoruesit dhe IPKO’s për shfrytëzimin e shërbimit të përzgjedhur nga ana e Përdoruesit, e cila përbëhet nga Kontrata për Abonim e nënshkruar mes Përdoruesit dhe IPKO’s, Shtojcat përkatëse, këto Kushte të Përgjithshme Abonimit, Kushtet e Veçanta të Abonimit, lista e publikuar e çmimeve të IPKO’s dhe dokumentet tjera përcjellëse.

“**Kontrata**” është dokumenti i cili nënshkruhet nga palët dhe përmban elementet thelbësore të detyrueshme për të cilat janë pajtuar palët.

“**Data e hyrjes në fuqi**” është data/koha në të cilën Kontrata është nënshkruar.

“**Aktivizimi/Data e lëshimit të shërbimit**” është koha nga e cila Përdoruesi ka qasje dhe mund të përdor shërbimin dhe/apo produktin e përzgjedhur.

“**Pezullim**” është gjendja në të cilën Përdoruesi nuk ka qasje në shërbime përkohësisht, ndërsa shërbimi nuk është anuluar ende.

“**Anulimi/Terminimi**” është gjendja në të cilën të gjitha shërbimet në të cilat Përdoruesi ka pasur qasje janë anuluar dhe nuk mund të përdoren pa ri – abonim.

“**Përdoruesi Shërbimeve**” është personi fizik i cili është i abonuar në një apo më shumë produkte dhe shërbime të ofruara nga IPKO, dhe i cili në mënyrë direkte, pranon Kushtet e Përdorimit të IPKO’s.

“**Rrjeti**” është hapësira ku lidhen pajisjet, pa ose me tel, që bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit.

“**Pajisjet**” janë instrumente të nevojshme për ndërmarrjen ose kryerjen e shërbimit. Ato mundësojnë kryerjen e detyrave me anë të përparësive mekanike, ose ofron mundësinë që nuk do të ishte e mundur t’i ofrohej në mënyrë natyrore Përdoruesit të shërbimit.

“**Modemi**” – është pajisje që mundëson lidhjen e kompjuterëve me rrjetin e IPKO’s dhe nga aty e drejton lidhjen në internet.

“**Kartela Smart (Smart Card)**” është Kartelë që futet në marrësin digjital dhe pa të cilën nuk mund të hapen paketat me kanale televizive.

“**Shërbimet**” janë produktet e ofruara të cilat përbajnë shërbimet e internetit, të televizionit digjital dhe shërbimet e telefonisë fikse për përdoruesit privatë me parapagim dhe/apo me faturim mujor.

“**Shërbimi TVIM**” është shërbim me vlerë të shtuar i ofruar për Përdoruesin e shërbimit të televizionit digjital që mundëson casjen në aplikacionin për telefon mobil, tablet ose laptop për të shikuar kanale të caktuara të IPKO’s, në po të njëjtat pajisje.

“**Shpejtësia minimale**” (Shpejtësia e garantuar) – është shpejtësia më e ulët, të cilën e ofron ofruesi i qasjes në internet për përdoruesin në përputhje me kontratën.

“**Shpejtësia maksimale**” – është shpejtësia që përdoruesi pret të pranojë së paku një pjesë të kohës (p.sh. së paku një herë në ditë).

“**Shpejtësia e reklamuar**” – është shpejtësia që një ofrues i shërbimit të qasjes në internet e përdor në komunikimet komerciale, përfshirë reklamimet dhe marketingun lidhur me promovimin e ofertave të qasjes në internet. Në rast se shpejtësitë janë të përfshira në një ofertë marketingu të ofruesit të qasjes në internet, shpejtësia e reklamuar duhet të specifikohet në informacionin e publikuar dhe në kontratë për secilën ofertë.

“**Shpejtësia e zakonshme në dispozicion**” është shpejtësia ku një përdoruesi mund të arrij shumicën e kohës gjatë qasjes në shërbime.

### 3. Obligimet e IPKO’s

#### Qasja në shërbimin e ofruar dhe cilësia e shërbimit

3.1 Për qëllime të nënshkrimit të Kontratës për Abonim dhe dokumenteve përcjellëse, me qëllim të abonimit në shërbimet e telekomunikimit të ofruara nga IPKO për përdorues privat, me faturim mujor dhe/apo parapagim, Përdoruesi duhet ta posedoj me vete dokumentin identifikues valid, për verifikimin e të dhënave personale. Në rast se në emër të Përdoruesit paraqitet personi i autorizuar, i njëjti duhet të ketë me vete Autorizimin si dhe dokumentin identifikues valid.

3.2 Qasja në shërbim, ndër të tjera, mundësohet nga pajisjet që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi, të cilat, përbëhen nga modemi, marrësi digjital, moduli dhe kartela smart. Të njëjtat, janë dhe mbeten pronë e IPKO’s, ndërsa Përdoruesit i jepen në shfrytëzim gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes. Me rastin e ndërprerjes së marrëveshjes, Përdoruesi është i obliguar që të kthejë të gjitha pajisjet që ka në shfrytëzim, jo më larg se pesë (5) ditë.

3.3 Shpejtësia minimale, shpejtësia e zakonshme në dispozicion si dhe shpejtësia maksimale e ngarkimit dhe shkarkimit varësisht nga kapaciteti/pako që Përdoruesi ka në shfrytëzim, do të variojnë si në vijim:

**3.4.1 Tabela më poshtë paraqet shpejtësinë e internetit për pakot me parapagim për shërbimet vetëm me vetëm internet dhe/apo me shërbime të kombinuara:**

| Pako Prepaid    | Shpejtësia e Shkarkimit (Do) |           |             | Shpejtësia e Ngarkimit (Do) |           |             | Limit transfer |
|-----------------|------------------------------|-----------|-------------|-----------------------------|-----------|-------------|----------------|
|                 | Max                          | Min (20%) | Usual (30%) | Max                         | Min (20%) | Usual (30%) |                |
| Duo Elite Plus  | 200 Mbps                     | 40 Mbps   | 60 Mbps     | 40 Mbps                     | 8 Mbps    | 12 Mbps     | unlimited      |
| Duo Family Plus | 100 Mbps                     | 20 Mbps   | 30 Mbps     | 20 Mbps                     | 4 Mbps    | 6 Mbps      | unlimited      |
| Duo Elite HD    | 60 Mbps                      | 12 Mbps   | 18 Mbps     | 12 Mbps                     | 2.4 Mbps  | 3.6 Mbps    | unlimited      |
| Duo Family HD   | 50 Mbps                      | 10 Mbps   | 15 Mbps     | 10 Mbps                     | 2 Mbps    | 3 Mbps      | unlimited      |
| Start           | 20 Mbps                      | 4 Mbps    | 6 Mbps      | 4 Mbps                      | 0.8 Mbps  | 1.2 Mbps    | unlimited      |
| Standard        | 60 Mbps                      | 12 Mbps   | 18 Mbps     | 12 Mbps                     | 2.4 Mbps  | 3.6 Mbps    | unlimited      |
| Elite           | 100 Mbps                     | 20 Mbps   | 30 Mbps     | 20 Mbps                     | 4 Mbps    | 6 Mbps      | unlimited      |
| PAKO 2 +        | 100 Mbps                     | 20 Mbps   | 30 Mbps     | 20 Mbps                     | 4 Mbps    | 6 Mbps      | unlimited      |
| PAKO 3+         | 150 Mbps                     | 30 Mbps   | 45 Mbps     | 30 Mbps                     | 6 Mbps    | 9 Mbps      | unlimited      |

**3.4.2 Tabela më poshtë paraqet shpejtësinë e internetit për pakot me faturim mujorë vetëm me internet dhe/apo me shërbime të kombinuara:**

| Pako Postpaid | Shpejtësia e Shkarkimit (Do) |           |             | Shpejtësia e Ngarkimit (Do) |           |             |
|---------------|------------------------------|-----------|-------------|-----------------------------|-----------|-------------|
|               | Max                          | Min (20%) | Usual (30%) | Max                         | Min (20%) | Usual (30%) |
| MAX MEGA HD   | 300 Mbps                     | 60 Mbps   | 90 Mbps     | 50 Mbps                     | 10 Mbps   | 15 Mbps     |
| MAX MEGA      |                              |           |             |                             |           |             |
| FAMILJA IME L |                              |           |             |                             |           |             |
| TOP XL        | 200 Mbps                     | 40 Mbps   | 60 Mbps     | 50 Mbps                     | 10 Mbps   | 15 Mbps     |
| MAX ELITE     |                              |           |             |                             |           |             |
| MAX SMART     |                              |           |             |                             |           |             |
| FAMILJA IME M |                              |           |             |                             |           |             |
| MAX FAMILJARE | 150 Mbps                     | 30 Mbps   | 45 Mbps     | 30 Mbps                     | 6 Mbps    | 9 Mbps      |
| TOP L         | 100 Mbps                     | 20 Mbps   | 30 Mbps     | 40 Mbps                     | 8 Mbps    | 12 Mbps     |
| MAX PRIME     | 100 Mbps                     | 20 Mbps   | 30 Mbps     | 20 Mbps                     | 4 Mbps    | 6 Mbps      |
| FAMILJA IME S | 100 Mbps                     | 20 Mbps   | 30 Mbps     | 20 Mbps                     | 4 Mbps    | 6 Mbps      |
| DUO ULTRA     | 60 Mbps                      | 12 Mbps   | 18 Mbps     | 12 Mbps                     | 2.4 Mbps  | 3.6 Mbps    |
| TOP M         |                              |           |             |                             |           |             |
| DUO LIGHT     | 50 Mbps                      | 10 Mbps   | 15 Mbps     | 10 Mbps                     | 2 Mbps    | 3 Mbps      |

3.5 Pranimi i shpejtësive të përshkruara më lartë, varet nga shumë faktorë, përkatësisht se sa pajisje janë të lidhura në pajisjen fundore të IPKO's, lokacioni i Përdoruesit, aplikacionet e ngarkuara në pajisjen e Përdoruesit si dhe konfigurimi i tyre, trafik i rënduar në një lokacion etj. Rrjedhimisht, shpejtësitë e përshkruara nga lartë do të sigurohen deri tek pajisja e IPKO', dhe IPKO nuk mund të kontrollojë pajisjet e Përdoruesit të cilat i njëjti i përdor për të marr shërbimin.

3.6 Për shërbimin e Internetit orët e pikut (peak hours) janë duke filluar nga ora 20:00 dhe zgjasin deri në orën 00:00.

3.7 Duke njoftuar paraprakisht Përdoruesin, IPKO rezervon të drejtën të ndërpresë ofrimin e shërbimit për arsye të mirëmbajtjes, avancimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit. Këto ndërprerje mund të zgjasin për aq kohë sa do të zgjasë kryerja e punëve.

3.8 IPKO do të ndërmarr masa të arsyeshme të menaxhimit të trafikut, në mënyrë që parandalojë bllokimin apo sigurinë e rrjetit, masa të tilla do të jenë proporcionale dhe do të zgjasin për aq sa është nevojshme/domosdoshme.

3.9 IPKO do të bëjë riparimin e pengesave duke u referuar në kushtet dhe nivelin e shërbimeve të raportuara nga matjet e bëra nga ARKEP, duke mos i përjashtuar edhe shërbimet e asistencës;

3.10 Në pajtim me këto Kushte të Përgjithshme të Abonimit, IPKO nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë ndërprerje, ose dobësim të shërbimit të internetit dhe /apo televizionit digjital për përdorues privat, apo për ndonjë defekt në rrjet, i shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, apo nga ndonjë rrethanë jashtë kontrollit të IPKO's, të cilën nuk mund ta parashikojë dhe parandalojë (forca madhore). Në rast të defekteve të mëdha në rrjete, IPKO do t'i ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për riparim sa më të shpejt të këtyre defekteve, duke e respektuar listën prioritare të nenit 16.1 të Rregullores Nr. Prot. 009/B/16 të ARKEP.

3.11 Në rast të ndryshimit të lokacionit, IPKO mbanë përgjegjësi për transferim të shërbimeve vetëm në zonat ku ka mbulueshmëri për ofrimin e shërbimeve të IPKO's, ndërsa nëse zona përkatëse nuk ka mbulueshmëri, IPKO nuk mbanë asnjë përgjegjësi për transferimin e shërbimeve përkatëse.

3.12 Në asnjë rast, IPKO nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmet indirekte, apo humbje të të ardhurash, shkaktuar Përdoruesit.

3.13 Asnjë siguri, apo garanci nuk mund të jepet lidhur me disponueshmërinë, cilësinë, funksionimin, apo mirëmbajtjen e trafikut të zërit, apo të të dhënave në rastet kur - Përdoruesi komunikon me individë që përdorin një operator tjetër telekomunikimesh.

**4. Obligimet e Përdoruesit**

4.1 Përdoruesi nuk lejohet të rishes asnjë produkt ose shërbim të dhënë nga IPKO përveç në raste kur ka pajtim me shkrim me marrëveshje të ndarë me IPKO-n.

4.2 Përdoruesi nuk lejohet të përdor ose lejoj përdorimin e Shërbimeve për ndonjë qëllim të ndaluar, të pahijshëm, të paligjshëm, të dëmshëm, të paautorizuar, diskreditues ose mashtrues ose të shkaktoj ndonjë lëndim, ofendim ose ngacmim të ndonjë personi ose të dërgoj mesazhe të padëshirueshme komerciale ndonjë personi. Përdoruesi nuk lejohet të përdor ose lejoj përdorimin e Shërbimeve, që do të shkaktojnë mosfunksionimin e rregullt të rrjetit ose kualitetin e Shërbimeve, dobësimin apo ndërprerjen apo ndërhyrjen në integritetin ose sigurinë e cילו rrjet apo sistem të telekomunikimit.

4.3 Përdoruesit i ndalohet keqpërdorimi i shërbimit, gjegjësisht, Përdoruesi është i obliguar të përdor shërbimet në përputhje me Marrëveshjen dhe ligjet në fuqi, përndryshe IPKO ka të drejtë të bashkëpunoj me organet kompetente të ligjit dhe, varësisht nga shkalla e keqpërdorimit IPKO ka të drejtë të marrë këto masa:

- i. T'ia tërheqë vërejtjen Përdoruesit që të shfrytëzojë shërbimin në pajtueshmëri me Marrëveshjen;
- ii. Të pezulloj apo anuloj automatikisht shërbimin e dhënë nga IPKO, pa kurrfarë përgjegjësie për kompensim ndaj Përdoruesit dhe si rezultat të kërkojë kompensim dëmsh të pësuar nga keqpërdorimi, bërë nga Përdoruesi.

4.4 Në rast se IPKO e anulon kontratën me Përdoruesin për arsye të cekura më sipër, ky i fundit është përgjegjës t'i kryejë të gjitha obligimet financiare të mbetura ndaj IPKO's, përfshirë këtu edhe kompenzimin e ndonjë dëmi eventual që IPKO mund të pësoj si rezultat i veprimeve të Përdoruesit.

4.5 Përdoruesi duhet menjëherë të lajmëroj IPKO' n në lidhje me problemet eventuale me shërbimet ose produktet që është duke i përdorur.

4.6 Përdoruesi duhet të ofroj shënime personale të sakta kur ato kërkohen nga IPKO. Për çdo ndryshim të këtyre informacioneve Përdoruesi duhet ta njoftoj IPKO-n brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e ndryshimit.

4.7 Përdoruesi është i obliguar të paguaj të gjitha pagesat dhe detyrimet në përputhje me Marrëveshjen.

## **5. Pajisjet e IPKO's dhe facilitetet e rrjetes:**

### **5.1 Pajisjet për ofrimin e shërbimit te Internetit:**

5.1.1 Modemi është pronë e IPKO's dhe Përdoruesit i jepet në shfrytëzim gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes. Me rastin e ndërprerjes së marrëveshjes, Përdoruesi është obliguar që ta kthejë atë jo më larg se 5 ditë.

Përdoruesi është i obliguar që të përdorë dhe mirëmbajë modemin sipas udhëzimeve të prodhuesit të tij, si edhe atyre të dhëna nga IPKO.

5.1.2 IPKO nuk mban përgjegjësi për prishjen e modemit si rezultat i pakujdesisë, apo mosdijes së Përdoruesit.

5.1.3 Në rast se Përdoruesi nuk u përmbahet rregullave për përdorimin e modemit dhe si rezultat i veprimeve të tij-saj modemi është i papërdorshëm, atëherë Përdoruesi duhet të paguajë për përdorimin e modemit të ri, çmimi i të cilit është i përcaktuar në listën e çmimeve të IPKO's.

5.1.4 Në rast të vjedhjes së modemit, Përdoruesi është i obliguar që të sjellë raportin për vjedhjen nga Policia e Kosovës, në mënyrë që të marrë modemin e ri. Në rast se Përdoruesi nuk mund ta sigurojë këtë raport, atëherë duhet të paguajë për përdorimin e modemit të ri.

5.1.5 Përdoruesi është përgjegjës për sigurinë e kompjuterit të tij, harduerit dhe softuerit apo pajisje te tjera ne përdorim, duke përfshirë dhe të dhënat e tij. IPKO nuk mirëmban kompjuterin dhe LAN -in e Përdoruesit dhe nuk mban kurrfarë përgjegjësie për dëmtimin, apo humbjen e këtyre të dhënave, si rezultat i përdorimit të shërbimit.

5.1.6 Duke i njoftuar paraprakisht Përdoruesit, IPKO ka të drejtë që t'i ndërroj pajisjet/modemin të cilët janë në shfrytëzim të Përdoruesit, me qëllim të mirëmbajtjes, avancimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit. Pajisjet mbesin në pronësi të IPKO's.

5.1.7 Te gjitha pajisjet qe përdoren nga përdoruesit duhet t'i përshtaten standardeve dhe specifikave teknike të aprovuara nga ARKEP dhe implementuara nga IPKO.

### **5.2 Pajisjet për ofrimin e shërbimit te Televizionit Digjital:**

5.2.1 Marrësi digjital, moduli dhe kartela smart janë pronë e IPKO's, ndërsa i ofrohen për përdorim Përdoruesit gjatë periudhës së kohëzgjatjes së Kontratës. Ndërsa paisja e televizorit objekt i Kontratës kryesore bashkë më shërbimet fikse i kalon në pronësi Përdoruesit në momentin që i njëjti ka kryer të gjitha obligimet financiare ndaj IPKO's.

5.2.2 Përdoruesi është i obliguar që t'i përdorë dhe mirëmbajë pajisjet sipas udhëzimeve të prodhuesit të pajisjeve, si edhe të atyre të dhëna nga IPKO. Për çfarëdo defekti pajisjesh sic janë marrësi digjital, moduli dhe kartela smart, Përdoruesi është i obliguar të kontaktoj IPKO'n, ndërsa për çfarëdo defekti të paisjeve se televizorit të blerë nga IPKO bashkë me shërbimin, objekt i Kontratës kryesore, Përdoruesi obligohet që ti drejtohet Servisit të autorizuar sipas informacioneve të dhëna në Garancionin e paisjes.

5.2.3 Riparimi i pajisjeve sic janë marrësi digjital, moduli dhe kartela smart do të bëhet nga kompania e kontraktuar nga IPKO, për çfarëdo riparimi të ndonjë defekti që rrjedhë nga përdorimi normal i pajisjeve. Ndërsa riparimi i paisjes së televizorit do të bëhet nga Servisi i autorizuar sipas kushteve të parapara në fletë garacion, pjesë përbërëse e kushteve të Kontratës.

5.2.4 IPKO nuk mban përgjegjësi për prishjen e marrësit digjital, modulit, kartelës smart apo televizorit si rezultat i pakujdesisë, apo mosdijes së Përdoruesit.

5.2.5 Përdoruesi është përgjegjës për çdo dhe të gjithë rrjetin elektrik të furnizimit me energji të lidhur me pajisjet që ofron shërbimin. Përdoruesi nuk do ta bëjë IPKO' n përgjegjës për çdo dhe të gjitha defektet dhe / ose dëmet që rezultojnë nga energjia elektrike me te cilën është e lidhur pajisja e shërbimit/marrësi digjital.

5.2.6 Përtokëzimi dhe masat mbrojtëse ndaj rrufesë dhe mbitensionit elektrik të pajisjeve dhe instalimeve shtëpiake të klientit (përveç marrësit digjital), janë pjesë e instalimeve dhe pajisjeve shtëpiake të Përdoruesit dhe në rast se ato pajisje dhe instalime nuk janë ekzekutuar/vendosur dhe kyçur sipas normave dhe standardeve rajonale, IPKO nuk mbanë asnjë përgjegjësi. Të gjitha dëmet eventuale të pajisjeve ose instalimeve të përdoruesit, që mund të shkaktohen ose shkaktohen nga jo korrektësia e këtyre masave mbrojtëse ose mosrespektimi i standardeve dhe normave rajonale, nuk do te kompensohet nga IPKO Telecommunications LLC dhe të gjitha garancionet do të jenë nule. Për sigurinë e Përdoruesit dhe të pajisjeve shtëpiake të Përdoruesit, rekomandohet që Përdoruesi të bëjë për tokëzimin në një pikë të përbashkët të gjitha video dhe audio pajisjeve dhe instalimeve të kyçura në rrjetin kabllor të IPKO Telecommunications LLC.

5.2.7 Në rast se Përdoruesi nuk ndjek rregullat për përdorimin e pajisjeve të përcaktuara në këto Kushte të Përgjithshme të Abonimit, dhe si rezultat i veprimeve apo mos-veprimeve të tij/saj marrësi digjital apo kartela smart nuk janë të përdorshme dhe janë dëmtuar, Përdoruesi duhet të blejë një marrësi digjital të ri dhe kartelë smart të re, çmimi i të cilave është i paracaktuar në listën e çmimeve të IPKO-s. Nëse IPKO konstaton se marrësi digjital, ose kartela smart janë të papërdorshme por që pa përdorshme e tyre nuk ka rrjedhë si pasojë e veprimeve apo mos-veprimeve te Përdoruesit, Përdoruesi do të pajiset me marrësi të njëjtë digjital apo kartelë smart, pa pagesë.

5.2.8 Për ndryshim të çfarëdo pajisje në shfrytëzim të Përdoruesit, Përdoruesi dhe IPKO do të nënshkruajnë formën për zëvendësim të pajisjes, në bazë të së cilës do të evidentohen pajisjet e reja në shfrytëzim të Përdoruesit.

5.2.9 Varësisht nga shërbimi që përzgjedhë Përdoruesi, nëse e paraparë me Kontratën e Abonimit, Përdoruesi mund të pajisjet dhe me Marrësi Digjital II dhe Kartelën Smart II. Të gjitha obligimet e aplikueshme për pajisjet e para të pranuar nga ana e Përdoruesit, do të aplikohen dhe për pajisjet sipas këtij paragrafi.

### **5.3 Lista e aktiviteteve parandaluese për mirëmbajtjen e pajisjeve e propozuar nga IPKO për përdoruesin e saj është si vijon:**

5.3.1 Në kohë të rrufesë përdoruesin duhet të shkyç pajisjet nga priza elektrike;

5.3.2 Përdoruesi duhet të sigurojë që i tërë rrjeti elektrik në shtëpi ka sistem tokëzimi me standard prej <50hm;

5.3.3 Përdoruesi këshillohet të përdorë/instalojë priza me mbrojtje nga tensioni në mënyrë që të mbrojë amvisërinë nga rrufetë dhe tensioni i lartë elektrik;

5.3.4 Përdoruesi këshillohet të përdorë korrektor të tensionit dhe UPS (furnizim i pandërprerë me rrymë) për të mbrojtur amvisërinë nga tensioni i paqëndrueshëm dhe ndërprerjet e rrymës elektrike;

#### **5.3.5 Udhëzime për kyçien e drejtë të pajisjeve të IPKO's:**

a) Marrësi digjital: Hapi 1: Shkyç TV; Hapi 2: Lidh kabllon RF (lidhësi i radio frekuencës) në IPKO STB; Hapi 3: Lidh kabllot e TV (HDMI – Multimedia Interfejs me Definim të lartë ose RCA fono lidhësin); Hapi 4: Kyç STB (Marrësi digjital ) në rrymë; Hapi 5: Hap TV dhe STB;

#### **5.3.6 Udhëzime për shkyçjen e drejtë të pajisjeve të IPKO's:**

a) Marrësi digjital: Hapi 1: Mbyll TV dhe the STB(Marrësi digjital); Hapi 2: Nxjerr kabllon e STB nga rryma; Hapi 3: Nxjerr kabllon IPKO RF (lidhësi i radio frekuencës) nga STB(Marrësi digjital); Hapi 4: Nxjerr kabllon HDMI (HDMI - Multimedia Interfejs me Definim të lartë).

5.3.7 Pajisjet/ fascilitetet e rretës të instaluar në lokacionin e Përdoruesit që konsiderohen pronë e IPKO's do të menaxhohen sipas Marrëveshjes. N' rast se këto pajisje/ fascilitete nuk janë te nevojshme për ofrimin e shërbimeve te kërkuara , përdoruesi nuk ka nevojë t'i paguaj të njëjtat.

5.3.8 Përdorimi i pajisjeve fundore te Përdoruesi është i kufizuar për shërbimet e televizionit digjital ne pajisje që ofrohen vetëm nga IPKO (marrësi digjital dhe kartela smart). Përveç pajisjeve të IPKO's që Përdoruesi i posedon gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, ky i fundit për përdorimin e shërbimit në fjalë, duhet të përdor vetëm modele të pajisjeve që janë në pajtueshmëri me të gjitha ligjet, standardet, rregullat, udhëzuesin e Përdoruesit dhe vetëm Përdoruesi është përgjegjës për mënyrën se si pajisjet përdoren.

5.3.9 Te gjitha pajisjet qe përdoren nga Përdoruesit duhet t'i përshtaten standarde dhe specifikave teknike te aprovuara nga ARKEP dhe implementuara nga IPKO.

### **6. E drejta e autorit**

6.1 Të gjitha programet e transmetuara në rrjetin kabllor digjital të IPKO's, janë të mbrojtura nga Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta si edhe ligjet e tjera relevante në fuqi në Kosovë. Është rreptësisht të ndaluar shumëzimi, ripublikimi, ruajtja, ritransmetimi, apo rishpërndarja e ndonjë nga programet e transmetuara në Televizionin Digjital Kallor të IPKO's, përveç për përdorim personal e assesi komercial.

6.2 Shërbimi TVIM është i limituar në rrjetin e IPKO's për shkak të drejtave për transmetim të përmbajtjes së kanaleve që ky shërbim i ofron.

### **7. Mbrojtja e të dhënave, privatësia e përdoruesve të IPKO's, bashkëpunimi me organe të rendit**

7.1 Mbrojtja e të dhënave, privatësia e përdoruesve të IPKO's . IPKO në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale përpunon te dhënat personale të përdoruesve të shërbimeve të saj të komunikimeve elektronike, që përfshijnë emër, mbiemër, numër personal, adresë, numër telefoni fiks, numër mobil, adresë email. - Përdoruesi mund të informohet lidhur me procedurat e ruajtjes dhe të përpunimit të të dhënave personale në faqen zyrtare të IPKO's <https://www.ipko.com/politika-e-privatesise-ipko-telecommunications-llc/> . Përdoruesi gjithashtu mund të paraqes çfarëdo kërkesë apo ankese me shkrim në lidhje me përdorimin e të dhënave, në email adresën [dpo@ipko.com](mailto:dpo@ipko.com).

7.2 Bashkëpunimi me organe të rendit. Përdoruesi mban përgjegjësi të plotë për informacionin, apo përmbajtjen e të dhënave, të cilat i transmeton dhe i bartë te personat e tretë nëpërmjet rrjetit të internetit të IPKO's. IPKO nuk mban kurrfarë përgjegjësie për këtë përmbajtje, si edhe as për të dhënat, të cilat Përdoruesi i pranon nga palët e treta, nëpërmjet rrjetit të IPKO's. Në pajtim me ligjet në fuqi në Kosovë, IPKO do të bashkëpunojë me organe të rendit për kërkesat që këto organe do të kenë lidhur me shërbimin në fjalë që përdor Përdoruesi.

### **8. Pezullimi dhe anulimi i shërbimeve**

8.1 IPKO mundet, me njoftim paraprak, të pezulloj Shërbimet Përdoruesit në tërësi ose pjesërisht në rast se Përdoruesi dështon të kryej detyrimet në afat të çfarëdo shume ndaj IPKO-s me anë të kësaj Marrëveshjeje në datën e caktuar të specifikuar në faturë, ose në rast të kryerjes së ndonjë aktiviteti mashtrues ndaj produkteve dhe shërbimeve të IPKO's.

8.2 IPKO mund, pa njoftim paraprak, të anuloj Shërbimet Përdoruesit për ndonjë arsye të bazuar, duke përfshirë, pa limitim:

- i. kur Përdoruesi nuk përmbush obligimet që dalin nga Marrëveshja (dhe veçanërisht Obligimet e Përdoruesit të përcaktuara në këtë dokument) ose ndonjë ligji.
- ii. Përdoruesi i ofron IPKO's informata të falsifikuara, të pasakta ose mashtruese ose nuk e njofton IPKO' n për ndonjë ndryshim që ngjan.

8.3 Në rast të anulimit, çfarëdo vlere e mbetur në llogarinë e Përdoruesit do të tërhiqet nga IPKO.

### **9. Forca Madhore**

9.1 Asnjëra palë nuk është e përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së obligimeve të shkaktuara nga ose që rezultojnë nga Forca Madhore që përfshin ngjarjet që janë të paparashikueshme, të papritura, të pa rezistueshme dhe përtej kontrollit të palëve, siç është moti i ashpër dhe ekstrem, përmbajtje, rrëshqitje dheu, tërmet, stuhi, vetëtimë, zjarr, akte terrorizmi, luftë (me apo pa deklarimin e luftës), pandemi, trazira, eksplodime, grevë ose protesta të punëtorëve, trazira civile, sabotazh, shpronësim nga ana e qeverisë ose akte tjera apo ndonjë ndodhi që është jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës përkatëse. IPKO nuk është përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së obligimeve në rast të:

- i. refuzimi apo vonesa nga pala e tretë për furnizimin e IPKO-s me shërbime të telekomunikimit dhe në rast kur nuk ka shërbim alternativ tjetër në dispozicion me çmim të arsyeshëm; ose
- ii. IPKO është i penguar nga kufizimet të natyrës ligjore apo të ARKEP të ofrojshërbimin e caktuar.

### **10. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe/apo emergjencës shëndetësore**

10.1 Në secilin rast, të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe/apo emergjencës shëndetësore në vend, IPKO do të ndërmerr të gjitha masat për koordinim efektiv për menaxhimin e situatës në përputhje me të gjitha rekomandimet nga Institutet përgjegjëse kombëtare, dhe të gjitha Vendimet e organit vendimmarrës.

10.2 IPKO nuk do të mbajë përgjegjësi për dështimin e përmbushjes së obligimeve që rezultojnë si rrjedhojë e kufizimeve të përcaktuara nga Vendimet e organit vendimmarrës në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, emergjencës shëndetësore, fatkeqësive dhe/apo gjendjeve të tjera të

shpallura në situata emergjente, të cilat ndikojnë në kufizimin e shfrytëzimit të resurseve të IPKO's.

**11. Ligji në fuqi**

9.1 Këto Kushte të Përgjithshme Abonimi, do të udhëhiqen dhe interpretohen në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

**12. Dispozitat përfundimtare**

10.1 Këto Kushte të Përgjithshme Abonimi, përbëjnë pjesë të marrëveshjes mes Përdoruesit dhe IPKO's.

10.2 Në rast se ndonjë dispozitë në këto Kushte të Përgjithshme Abonimi, është e paligjshme ose e pa zbatueshme, e njëjta do të largohet ndërsa, dispozitat e mbetura do të qëndrojnë në fuqi dhe IPKO do të gjej me kohë zëvendësim.

10.3 Në rast se ndonjë dispozitë në këto Kushte të Përgjithshme Abonimi bien ndesh me ndonjë dispozitë në Kushtet e Veçanta të Abonimit, të cilat rregullojnë kushtet për shfrytëzimin e shërbimeve specifike, dispozitat në Kushtet e Veçanta të Abonimit do të mbizotërojnë.

10.4 Këto Kushte të Përgjithshme Abonimi janë të publikuara në uebfaqen e IPKO's për favorin e Përdoruesve, ndërsa të njëjtat nuk kanë nevojë të nënshkruhen nga ana e Përdoruesit dhe apo IPKO's, por që, janë në efekt, nga momenti i nënshkrimit të Kontratës së Abonimit nga ana e Përdoruesit, siç pajtohet dhe në Kontratë.